



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 728, datë 05.12.2024

**PËR
DËRGIMIN E EMRIT TË KANDIDATIT I CILI KA APLIKUAR PËR T’U
KOMANDUAR NË POZICIONIN “INSPEKTOR” NË ZYRËN E INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenet 53, 54, 55, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr.284, datë 29.05.2024, si dhe pas vlerësimit të kërkesës së gjyqtarës znj. {...},

V E N D O S I :

1. T’i dërgohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë emri i znj. {...}, e cila ka aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “Inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe praktikën dokumentare.
2. Vendimi nr. 700, datë 03.12.2024, për kualifikimin e kandidates znj. {...}, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij opinionioni.
3. Publikimin e këtij opinionioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

OPINION

**MBI KANDIDATËT QË KANË APLIKUAR PËR T'U KOMANDUAR NË
POZICIONIN “INSPEKTOR” NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË**

I. HYRJE

1. Siç u parashtruar edhe në relacionin për “për kualifikimin e kandidates znj. {...} për t’u komanduar në pozicionin “Inspektor” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 97, në pika 1 dhe 5 të nenit 209 dhe në nenin 211, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 53, 54, 55, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. vendimin nr.284, datë 29.05.2024 ka vendosur: “Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për tre pozicione: “Inspektor”.

2. Me shkresën nr. 3175, datë 11.06.2024, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për pozicionin “Inspektor”.

2.1 Lidhur me dokumentet të cilat duhet të paraqesë në momentin e aplikimit kandidati sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 4 të vendimit nr.284, datë 29.05.2024, rezultoi se znj. {...} ka paraqitur dokumentacionet si vijon :

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që mban datën 10.06.2024;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, që mban datën 10.06.2024;

-Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të shkronjës “dh”, pika 5, të nenit 209, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, që mban datën 10.06.2024;

- Vërtetim/Dëshmi nga Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) për mosqenien i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që mban datën 05.06.2024.

3. Në vendimin nr. 284, datë 29.05.2024 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli : *“Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, do të vlerësojë **plotësimin e kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë.** Ky vlerësim do bëhet brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit. Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, i cili shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.”*

- Sipas parashikimit të bërë **në pikën 13 të Kreut II**, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjell menjëherë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë aplikimet e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për komandimin në pozicionin “Inspektor”.

- **Në pikën 15 të këtij Kreu**, parashikohet se: “Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendos për komandimin, në pozicionin respektiv të kandidatit të përzgjedhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.”

II. VLERËSIMI I KOMISIONIT

4. Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 284, datë 29.05.2024 të Këshillit në fazën e parë, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin ose e thënë ndryshe do të vlerësohet nëse largimi i saj përkohësisht mundet të cenojë mbarëvajtjen dhe funksionimin e gjykatës për shkak të organikës së mangët të burimeve njerëzore që Gjykata e Tiranës ka aktualisht.

5. Në lidhje me kushtet e përgjithshme të komandimit.

6. Dispozitat e parashikuara nga nenet 53 dhe 54 të Ligjit për Statusin kanë rregulluar çështje të një natyre të përgjithshme mbi institutin e komandimit të magjistratëve ndërkohë që neni 55 i kushtohet vetëm njërës kategori të magjistratëve të komanduar dhe vetëm njërit institucion ku ato komandohen. Konkretisht neni 55 i këtij ligji i kushtohet posaçërisht magjistratëve/gjyqtareve të cilët komandohen si inspektorë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

7. Kushtet e komandimit përcaktohen në nenin 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ndërkohë që ata duhet të gëzojnë edhe kriteret e përcaktuar nga neni 209 pika 5 Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Po ashtu ato janë përcaktuar në pikën 7, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr. 284, datë 29.05.2024. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet se: “Kushtet e komandimit janë:

- a) *Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;*
- b) *Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;*
- c) *Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;*
- ç) *Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:*
 - i) *duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;*
 - ii) *nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës.*

7.1 Lidhur me kushtet e komandimit sipas shkronjave “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 7, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, sipas informacionit të marrë, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidatit, rezulton se: *znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 06.07.2000, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2003 dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në të drejtat e njeriut, Suedi, në vitin 2008 si dhe ka përfunduar studimet në Master ndërkombëtar në të drejtën evropiane, në Hollandë, në vitin 2018. Me Vendim nr. 132/1, datë 21.10.2002 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet provizorisht gjyqtare dhe caktohet për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me dekret nr. 3984, datë 21.10.2003 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare ushtarake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Vendim nr. 415, datë 16.12.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i akordohet leje për të shërbyer si Ndihmëse Ligjore në Gjykatën e Lartë, për periudhën nga 01.01.2014- 01.07.2015. Me Vendim nr. 55, datë 02.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i akordohet leje për të shërbyer si Ndihmëse Ligjore në Gjykatën e Lartë, për periudhën nga 01.07.2015- 01.01.2017 dhe në përfundim të këtij afati kthehet në detyrë si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Vendim nr. 41, datë 15.09.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i akordohet leje për shkëputje të përkohshme nga puna për efekt specializimi, për periudhën nga 06.11.2017-01.09.2018. Me vendim nr. 293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet zgjedhja si Anëtare e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, me mandat 4 vjeçar. Me vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të*

Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Me vendim nr. 171, datë 03.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet kërkesa për dhënie leje të papaguar për qëllime kualifikimi dhe specializimi, nga data 08.04.2024-02.05.2024. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit (gjyqtar) është 21 vjet. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

7.2 Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për Inspektor në ILD, rezulton se nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, nuk është e komanduar, por ka qenë më parë e komanduar për një periudhë 3 vjeçare në pozicionin e Ndhmëse Ligjore në Gjykatën e Lartë.

7.3 Lidhur me kushtet e komandimit sipas shkronjave “a”, “Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit” të pikës 7, Vendimit të Këshillit nr. 284, datë 29.05.2024, si dhe referuar kërkesës për informacion, nga ana e Komisionit, në rrugë elektronike drejtuar zv. Kryetarit të Gjykatës Tiranë sipas informacionit të marrë, nga ky i fundit lidhur me cenim e interesit të lartë dhe funksionalitetit të saj, rezulton se: “...Në përgjigje të e-mail-it tuaj ku keni kërkuar informacion për kandidimin e gjyqtare {...} në Zyrën e Inspektorati të Lartë të Drejtësisë bashkëngjitur do të gjeni ngarkesën e gjyqtarëve për periudhën 01.01.2024 deri më 11.11.2024¹. Për sa i përket pikës së dytë lidhur me pasojat që krijohen për gjykatën për komandimin e gjyqtare {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm janë emëruar dhe priten të emërohen gjyqtarë të rinj dhe në këto kushte mendoj se kandidimi i saj nuk shkakton efekte negative për Gjykatën.”...

7.4 Nw pamje tw pamje tw parw rezulton se ngarkesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është relativisht shumë e lartë. Natyrisht në identifikimin e kësaj Gjykate, ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme gjyqtarja që ka shprehur interesin, Komisioni vlerësoi në mënyrë krahasimore përballje midis të drejtave të përdoruesve të kësaj Gjykate për një gjykim të shpejtë, ngarkesës së gjyqtarëve të këtij Institucioni, nevojës thelbësore të Inspektorit për të pasur pranë tij komponentë të gjyqësorit, ekspertë të ligjit, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese, numrit të përcaktuar nga ligji për ta në përbërjen e Institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nevoja për instrumente balancimi. Parimi i proporcionalitetit rezulton të jetë një instrument i cili ndihmon arritjen e një vendimmarrje të drejtë. Theksojmë se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për zhvillimin e hetimit disiplinor të gjyqtarëve, komandimet e tyre në këtë Zyrë përbën jo vetëm detyrim ligjor por për shkak të njohurive të kërkuara edhe domosdoshmëri, duke u kujdesur të ruhet një raport i përshtatshëm, e i arsyeshëm në përputhje me gjendjen e sistemit.

¹ Bashkëlidhur këtij Projekt -Opinion do të gjeni tabelën e ngarkesës së gjyqtarëve për periudhën 01.01.2024 deri më 11.11.2024.

7.4.1 Afirmimi i parimit së të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë karakter absolut, nënkupton që ato mund të janë objekt i kufizimeve. Këto të fundit mbeten në vlerësim të strukturave vendimmarrëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 17, sanksionohet standardi kushtetues i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, i cili vendos një sërë kriteresh kumulative në formën e garancive kushtetuese për kufizimin e të drejtave themelore. Neni 17 përcakton, *inter alia*, se kufizimi i të drejtave themelore duhet të bëhet për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

7.4.2 Duke marrë shkas nga ky kriter, paraqitet e qartë se që një e drejtë të kufizohet, procesi i kufizimit do të përballë këtë të drejtë me interesat publikë ose me të drejta të tjera. Duke u nisur nga natyra e së drejtave, është e nevojshme që raporti midis tyre të përcaktohet nga instrumente balancimi të cilat të mundësojnë që ky raport midis të drejtave të realizohet përmes një strukture logjike argumentimi pavarësisht sa të ndryshme janë këto të drejta dhe interesa nga njëri-tjetri. Këtij qëllim i shërben dhe parimi i proporcionalitetit, Neni 17 i Kushtetutës përcakton detyrimin që kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të jenë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar kufizimin. Pra, raporti përpjesëtimor duhet të dëshmojë se në çmasë kjo përballje midis të drejtave mundëson një balancë të drejtë midis të drejtës së kufizuar (mjeti, largim/komandim i gjyqtarit) dhe mbrojtjes së një interesi publik për gjykime të shpejta ose të të drejtës së të tjerëve (numrit të përcaktuar nga neni 209 pika 1 e Ligjit për Qeverisjen (qëllimi).

7.4.3 Tradicionalisht ky parim konsiderohet se përbëhet nga 3 elementë. Këshilli duhet të vlerësojë nëse masa e ndërmarrë për të mbrojtur një interes të ligjshëm është:

- a) e përshtatshme për arritjen e objektivit të kërkuar.
- b) e domosdoshme, në kuptimin që KLGJ nuk kishte asnjë mundësi tjetër në dispozicion që të jetë më pak kufizuese ndaj përdoruesve të gjykatave reciproke në drejtim të një gjykimi të shpejtë. Kjo do të thotë se masa e ndërmarrë duhet të jetë e nevojshme për të përmbushur një qëllim të caktuar dhe se ky i fundit nuk mund të arrihet me anë të masave të tjera të cilat janë të efektshme dhe njëkohësisht më pak të dëmshme për interesat e individëve;
- c) proporcionale. Në bazë të këtij elementi të tretë, kontrolli është i orientuar drejt peshimit të interesave të përfshira në konflikt. Pra, përparësitë për të cilat ajo është e preferuar mbi masa të tjera, nuk janë në përpjesëtim me dëmin që ato shkaktojnë.

7.5 Nga vlerësimi i “ekuilibrimin të drejtë të interesave” rezulton se komandimi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sjell më shumë dobishmëri dhe efektshmëri shërbimi i znj. {...} pranë kësaj të fundit sesa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kjo jo vetëm për faktin e rëndësisë së jashtëzakonshme të prezencës së gjyqtarit në burimet njerëzore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është përgjegjës për zhvillimin e hetimit disiplinor të gjyqtarëve por edhe me pa mundësinë e sistemit për ta plotësuar edhe më shumë me gjyqtar këtë komponentë të ILD^s siç kërkohet nga ligji, (neni 209/1 i Ligjit Për Qeverisjen) . Vlerësimi objektiv i dobishmërisë dhe efektshmërisë si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre na lejon të konkludojmë se përmbushen të gjitha kriteret ligjore që mundësojnë komandimin e saj pranë

ILD-s ne raport me mos cenimin e funksionalitetit të Gjykatës së Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

7.6 Në kushtet e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallë së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin “Inspektor” në Zyrën e Inspektori të Lartë të Drejtësisë, përballë ngarkesës së çështjeve që kjo gjykatë ka dhe numrit aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë kësaj gjykate, sikundër dhe pritshmërisë pozitive dhe finalizimit që do të sjellë dhe plotësimi i vendeve nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele të ndërmarra prej kohësh nga ana e Këshillit, në faza konkluduese, nuk pasjellë cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet.

8. Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës harton Projekt-opinionin për kandidaten e vetme znj. {...}. Në përgatitjen e këtij opinionin për këtë candidate, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kushtet ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim dhe më pas harton një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin ose e thënë ndryshe do të vlerësohet nëse largimi i saj përkohësisht mundet të cenojë mbarëvajtjen dhe funksionimin e gjykatës për shkak të organikës së mangët të burimeve njerëzore që Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka aktualisht.

9. Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë:

9.1. T’i dërgohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë emri i znj. {...}, e cila ka aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “Inspektor” në Zyrën e Inspektori të Lartë të Drejtësisë, si dhe praktikën dokumentare.

9.2. Vendimi nr. 700, datë 03.12.2024, për kualifikimin e kandidates znj. {...} i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij opinionin.

9.3 Publikimin e këtij opinionin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS